PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJËSIVE NË VARËSI.

Administrimi i lagjes.

Në rastin e krijimit të lagjeve, sipas pikës 3, të nenit 6, të Ligjit Nr. 139/2015" Per Vetqeverisjen Vendore ", në secilën lagje krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij. Administrata e lagjes kryen të gjitha detyrat administrative, të ngarkuara nga Kryetari i Bashkisë, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagjen përkatëse.
Detyrat më të hollësishme përcaktohen në aktet e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë.

Struktura komunitare në qytet.

Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.
Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.
Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlidhësit komunitarë që drejtojnëdhe organizojnë punën e këshillave.
Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë qënë një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apomë shumë lagjeve.

Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar.

Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.
Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të Këshillave Bashkiakë, kanë të drejtë të kryejnëfunksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga kë shilli. Në kë të rast, Këshilli Bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apokompetencës së deleguar, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.
Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përditësuar në datë 16.03.2026

Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillitbashkiak.

Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit.

Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.
Bazuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë, Kryetari ose Kryesia e fshatit mund të kryejë edhe detyrat si më poshtë:
kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;
kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdolloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat;
c) administrimin e varrezave të fshatit;
ç) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.
Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në Rregulloret dhe urdhëresat e Këshillit Bashkiak.
Kryetari pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.
Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë përkatëse janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.
Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij pa të drejtë vote. Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje qëjanë të lidhura me fshatin përkatës.